



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 39 prot.

Kamëz, më 16 .03.2021

V E N D I M

Nr. 34 , Datë 16 .03.2021

P Ë R

**PËR EMËRTIMIN E NJË RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË KAMËZ**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 16.03.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim kërkesen për ndryshimin e emërimit të rrugës nga "DRINI" he "SHEN GJON PALI II" Datë 11.03.2021, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nënpika 1.7, shkronja "b", nenit 54, shkronja "II" dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; nenit 3, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004, "Për sistemin e adresave", të ndryshuar; **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

V E N D O S I :

1. Emërtimin "GJON PALI II", rrugës sipas fragmentit të hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi, shfuqizohet.
3. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Nën/ Kryetar Këshilli  
Ali Dauti

